



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:064507
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05637078

KPPP.nr.872/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit “ELK Group” ShPK me numër unik identifikues 811235995 seli në Gjakovë, me adresë në Rr. ”Patriot Berisha”, kundër debitorit “Art Caffè” O.P, me numër unik identifikues 811235995 me seli në Kaçanik, me adresë në Rr.”Ismail Raka”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.308/2023 të datës 19.05.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Fadil I. Hoxha me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 29.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

1. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “Art Caffè” O.P, me numër unik identifikues 811235995 me seli në Kaçanik, me adresë në Rr.”Ismail Raka” i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.308/2023 të datës 19.05.2023 të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Fadil I. Hoxha, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, me Urdhrit Përmbartimor P.nr.308/2023 të datës 19.05.2023, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, e ka caktuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm–faturës nr.020823001-1 të datës 08.02.2023, me të cilin ka urdhëruar që në emër të

përmbushjes së obligimeve, t'i paguajë kreditorit shumën e prej 333.27Euro, me kamatën referente si pjesë e kamatës ligjore, duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore.

Kundër urdhrit të Përbaruesit Privat, ka ushtruar prapësim debitori, me arsyetimin se ka pranuar mallin sipas faturës me numër 020823001-1 të datës 08.02.2023, ku një pjesë të detyrimit e ka paguar edhe atë shumën në vlerë prej 5,000.00eurove ndërsa shumën e mbetur në vlerë prej 333.27euro nuk e ka paguar dhe për të njëjtën shumë e ka lajmëruar edhe kreditorin duke shtuar se një pjesë e mallit ka qenë e dëmtuar andaj si rrjedhojë ka propozuar që t'i sillet mall i ri pa të meta dhe atëherë do ta përmbushë detyrimin në tërësi.

Tutje ka shtuar se fatura në fjalë nuk është titull përbarues bazuar në nenin 55 të Ligjit për Procedurën Përbarimore, ngase në mes të palëve ka kontest lidhur me këtë borxh dhe si e tillë fatura përmban të metat e cekura si më lart.

I ka propozuar gjykatës që ta aprovojë në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit dhe të anulohen të gjitha veprimet e deri tanishme nga përbaruesi privat .

Shpenzimet e procedurës përbarimore i ka kërkuar.

Kreditori në përgjigje në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka theksuar se debitori ka qenë i obliguar t'i paguajë kreditorit shumën si në faturën e lartcekur mirëpo një gjë të tillë e ka bërë vetëm pjesërisht ku ka paguar pjesën dërmuese të detyrimit ndërsa ka mbetur e pa paguar shuma në vlerë prej 333.27euro.

Ka shtuar se urdhri përbarimor është në harmoni të plotë me dispozitat ligjore përkatësisht nenin 29 par.3 të Ligjit për Procedurën Përbarimore.

I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit dhe të detyrohet i njëjti që t'i kryejë shpenzimet procedurale.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “*Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërkaq me paragrafin 3 të po të

njëjtë nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarrim dokumentin e besueshëm faturën nr. 020823001-1 të datës 08.02.2023 në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtjesore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura nr. 020823001-1 të datës 08.02.2023 i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarrimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit, e njëjta është dorëzuar në origjinal dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky i cili vërtetohet me nënshkrimin e debitorit.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se nuk ka paguar një pjesë të detyrimit me arsyen se një pjesë e mallit ka qenë e dëmtuar dhe se detyrimin e ka përmbushur vetëm pjesërisht, mirëpo gjeti se pretendimet e tilla nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarrimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigozitetit formal, në bazë të të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të të cilit është lejuar përmbarrimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarrimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së, andaj si rrjedhojë debitori të drejtën e tij mund ta realizojë në procedurat tjera gjyqësore.

Bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarrimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.872/23, me datë 29.01.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.